



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

## BURSA STUDIMI NË AZERBAJXHAN

Organizata për Bashkëpunim Islamik (The Organization for Islamic Cooperation, OIC) në bashkëpunim me Agjencinë për Zhvillimin Ndërkombëtar të Azerbajxhanit (*Azerbaijan International Development Agency, AIDA*) për vitin akademik 2019-2020 ka shpallur programin e bursave studimore për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të studiojnë në programe të plota studimi Bachelor, Master dhe Doktoraturë pranë universiteteve shtetërore të Azerbajxhanit. Bursat e studimit ofrohen vetëm për vendet që janë anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Islamik.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi deri më datë 13.02.2019 duhet të dërgojnë me postë në Drejtorinë e Integritit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë dokumentet përkatëse sipas informacionit bashkëlidhur. Dokumentacioni duhet të shoqërohet me kërkesën e firmosur nga kandidati drejtuar MASR (ku të jepet një adresë kontakti e-mail dhe numër telefoni), duke specifikuar fushën e studimit në të cilën dëshiron të studiojë kandidati.

*Bursa mbulon shpenzimet e ushqimit, të akomodimit, tarifën e shkollimit dhe të regjistrimit, shpenzimet për një biletë udhëtimi vajtje ardhje me avion gjate periudhës së studimeve dhe siguracionin shëndetësor.*

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni adresës në web-site:

<http://www.Aida.az/scholarship>;

[http://mfa.gov.az/folder/file/Call\\_for\\_Application\\_%202019](http://mfa.gov.az/folder/file/Call_for_Application_%202019).

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**